

VENDIM
Nr.1667, datë 24.12.2008

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2008, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT, NË GREQI, TË Z. MEVLAN SHANAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2008, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi 1 875 000 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për përballimin e shpenzimeve të kurimit, në Greqi, të z. Mevlan Shanaj.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha